

AMNISTIA FISKALE, EFEKTET E SAJ NË BASHKITË DHE KOMUNAT REFORMA PËR FUNKSIONIMIN E KASAVE FISKALE KA DËSHTUAR

nga Niko NAKO – Kryeauditues,
botuar në gazetën “Telegraf”, më 18 maj 2015.



Nga të dhënat e paraqitura rezultojnë se të ardhurat nga vetë pushteti vendor për vitin 2013, janë realizuar në 110.2 % të kuotave të planifikuara, ndërsa shpenzimet janë realizuar në nivelin 104.2 % të shprehur në % kundrejt PBB-së, këta tregues rezultojnë përkatësisht në 0.8 % të PBB-së dhe 2.2 % të PBB-së.

Shpenzimet faktike rezultojnë në shumën 29

787 milionë lekë nga 28 580 milionë lekë të planifikuara ose në masën 104.2% kundrejt planifikimit, me një tejkalim të shpenzimeve në vlerë prej 1 207 milionë lekë. Kundrejt PPB-së rezultojnë në rreth 2.2 % pothuajse në të njëjtin nivel me dy



vitet e mëparshme buxhetore.

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor për vitet 2007-2013 paraqitet:

Në milion lekë

Nr.	EMËRTIMI	VITET						
		2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
a	Shpenzimet e pushtetit Vendor	21340	27079	33589	30764	28119	27333	29787
b	Të ardhurat e pushtetit Vendor	9366	11307	12149	11898	11797	10859	10825

Shënim: Burimi i të dhënave nga Ministria e Financave

Megjithëse planifikimi i të ardhurave në shumicën e njësive vendore është me rezerva dhe më i ulët krahasuar me vitin e mëparshëm përsëri mjaft prej tyre rezultojnë me mosrealizime të konsiderueshme në vlerën **1 014 754 mijë** lekë ku përmendim:

- **Bashkitë:** Vlorë 386 000 mijë lekë, Elbasan 216 790 mijë lekë, Fier 206,544 mijë lekë, Korçë 177 621 mijë lekë, Laç 16 513 mijë lekë, Kamzë 51 714 mijë lekë, Rrogozhinë 14 472 mijë lekë, Berat 34 267 mijë lekë, Ura-Vajgurore më pak 18 961 mijë lekë, Korçë 177 523 mijë lekë, etj.

- **Komunat:** Golem më pak 16 447 mijë lekë; Farkë 47 154 mijë lekë; Rrashbull 40 718 mijë lekë, Shenkoll-Lezhë 23 325 mijë lekë, Udenisht-Pogradec 6 183 mijë lekë; Qendër Librazhd 8 125 mijë lekë; Komuna Pezë - Tiranë më pak 1 085 mijë lekë, etj.

Nga auditimi që ka ushtruar KLSH në Bashkinë Himarë rezulton se në juridiksionin e kësaj bashkie ushtrojnë aktivitet sezonal (dhoma me qera dhe hotele) 318 subjekte me një numër prej 1659 dhoma, ku detyrimi fiskal i pamaturuar paraqitet në vlerën 18 663 750 lekë, ku nga mos vjelja e kësaj takse i shkaktohet buxhetit të bashkisë Himarë çdo vit një dëm ekonomik (të ardhura të munguara) në vlerën 6 223 264 lekë.

Përveç të dhënave të trajtuara më sipër që në fillim të këtij shkrimi, sqaroj se nuk marr përsipër të bëj analizën dhe efektivitetin që **solli amnistia fiskale** në shkallë vendi në zbatim të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011 "*Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor*", ku pavarësisht veçorive dhe specifikave të zbatimit të këtij ligj, në thelbin e tij, ligji kishte faljen apo fshirjen nga regjistrat e kontabilitetit tatimor të detyrimeve dhe gjobave të papaguara deri më datën *31.12.2010*.

Përkufizimet rreth ekonomisë informale janë të ndryshme në shumë aspekte, por në çdo rast lidhen para së gjithash me fenomenet e evazionit fiskal dhe punës në të zezë. Mbase më e saktë do të ishte të thuhej se ekonomia informale është ajo pjesë e ekonomisë së ligjshme (jo e ndaluar dhe kriminale), e cila nuk respekton kuadrin ligjor në fuqi dhe që do të ishte objekt tatimi, në rast se do të raportohet tek organet fiskale. Si pasojë, kemi më pak të ardhura qeveritare, investime më të ultë private dhe rritje të varfërisë dhe jobarazisë



së qytetarëve. Studime të shumta, konfirmojnë ekzistencën e një korrelacioni negativ ndërmjet korrupsionit dhe rritjes ekonomike.

Pas 4 vjetësh të amnistisë fiskale dikush duhej të bënte analizën, efektet pozitive përfitimet në buxhet, probleme që shpesh sjellin iniciativa të tilla të ligjvënësit, për të çliruar bizneset nga debitë e ndryshme. Amnistinë Fiskale e kanë aplikuar shumë vende në botë, por në disa vende ka dhënë efekte, në disa të tjera ka dhënë efektin e kundërt, duke favorizuar tatimpaguesit e parregullt dhe diskriminuar ata që paguajnë rregullisht. Kjo për arsyen se ecet me mendimin se edhe po të jemi debitorë, përsëri do ketë amnisti fiskale, pra falje masive.

Nuk mohohet impakti që ka dhënë në rritjen e të ardhurave të buxhetit, sidomos të viteve 2012-2013, kur edhe kjo amnisti është zbatuar. Thuhet se janë përfituar me miliarda lekë nga kjo amnisti sidomos për legalizimin e kapitalit në drejtim të rivlerësimit të tokave dhe banesave. Por nuk ka shifra konkrete.

Do të kisha dëshirë të bëja këtë analizë, por siç janë në dijeni taksapaguesit shqiptarë, KLSH, i ka pasur duart të "lidhura" pasi ka 4 vjet që nuk është lejuar të auditojë administrimin e tatimeve dhe taksave, për "kapriçio" të këtij, apo atij, ish-ministri apo ish-drejtori të Përgjithshëm të Tatimeve. Dhe pasojat dihen, mos prezenca e KLSH, në auditimin e tatimeve do të kishte minimizuar evazionin fiskal dhe sadopak "çudirat" që po dëgjojmë me rimbursimet fiktive të t.v.sh., etj.

Megjithë punën që ka bërë KLSH, edhe nëpërmjet procese gjyqësore, theksojmë këtu luftën vetëmohuese të bërë nga Kryetari i KLSH nëpërmjet argumentimit të nevojës së auditimit të të hyrave në buxhet, Kuvendi me ligjin e Ri, nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i hapi dritën jeshile organit suprem të auditimit KLSH, që duke filluar nga **6 shkurti i vitit 2015** do jetë prezentë edhe në organet tatimore. U korrigjua një gabim që shtetit i ka kushtuar miliona dollarë.

Në këtë shkrim do bëj prezent disa probleme dhe efekte që ka dhënë zbatimi i amnistisë fiskale në taksat e pushtetit vendor dhe diçka për efektivitetin e vendosjes së kasave fiskale.

Bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 12, datë 18.5.2011“ *Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”*, kap II.1 - Falja e detyrimeve tatimore, pika 3 germa “a” përcaktohet se: Falen detyrimet tatimore të papaguara nga personat fizikë, subjekte të taksës vendore të biznesit të vogël që i përkasin periudhës tatimore deri në 31.12.2010 dhe që janë të evidentuar në kontabilitetin tatimor, sistemin informatikë, falen pa asnjë pagesë.

Pavarësisht se debitorët e taksave vendore deri në fund të vitit 2010 janë falur nga amnistia fiskale, ndërkohë nga auditimi rezulton se përsëri gjatë viteve 2012-2013 në bashkitë dhe komunat janë krijuar debitorë të rinj në vlerën **mbi 856 846 mijë lekë, të analizuara si më poshtë:**

Nr	Emërtimi	Në 000/lekë	Nr	Në 000/lekë	Në 000/lekë
A	BASHKITË	762 423		BASHKITË	
1	Korçë	94 137	16	Ura Vajgurore	2 401
2	Peshkopi	7 728	17	Shijak	906
3	Vorë	48 171	18	Durrës	20 550
4	Krujë	10 000	19	Divjakë	9 362
5	Përrenjas	3 276	20	Fier	5 978
6	Lushnjë	27 293	21	Çorovodë	5 703
7	Sarandë	79 311	22	Bilisht	2 276
8	Ksamil	4 189	23	Bulqizë	2 231
9	Himarë(20 hotele)	28 370	24	Kuçovë	2 236
10	Vlorë	210 000	25	Krumë	1 976
11	Elbasan	76 490	26	Koplik	1 047
12	Berat	34 500	27	Këlcyrë	876
13	Shkodër	32 016	28	Belsh	756
14	Kamzë	24 558	29	Roskovec	295
15	Rrogozhinë	25 146			
B	KOMUNAT	95 193		KOMUNAT	
1	Bilisht Qendër	34	7	Udenisht- Pogradec	5 800
2	Dishnicë Përmet	736	8	Shënkoll-Lezhë	4 505
3	Golem	42 704	9	Rremas-Lushnjë	3 838
4	Rrashbull	19 130	10	Kodër Thumanë	3 597
5	Pezë	6 152	11	Komuna Farkë	738
6	Librazhd Qendër	7 960			
GJITHSEJ (A+B)					856 846

Bëmë prezent shifrat e mësipërme për të kuptuar se amnistia fiskale në pushtetin vendor nuk ka dhënë efektin e duhur, pasi në vend që të ulëshin debitorët, ato janë rritur, madje në mënyrë “galopante”.

Lind pyetja, se a duhet të bëjmë përsëri amnisti fiskale?

Referuar shifrave të mësipërme mendimi im individual është JO-JO. Edhe nëse do bëhet, pa u kryer analiza dhe përfitimet e amnistisë fiskale të vitit 2011, në asnjë mënyrë të mos mendohet dhe jo më të ketë përsëri amnisti fiskale, kjo për pushtetin vendor.

Dhe dy fjalë për efektivitetin e vendosjes së kasave fiskale.

Megjithëse kemi pak të dhëna për vendosjen e kasave fiskale, mendohet se janë vendosur në shkallë Republike rreth 80 000 kasa fiskale x 350 Euro për 1 kasë= 28 milion Euro.

Kasat fiskale kryesisht shërbejnë për ato subjekte që realizojnë një xhiro jo më pak se 8 milionë lekë në vit, të cilët kur e tejkalojnë atë, nëpërmjet pasqyrimin të xhiros në Kasë fiskale, subjekti raporton online dhe kështu në mënyrë automatike ai kalon në subjekt me t.v.sh. Por kjo logjikë ka dështuar, pasi subjektet e pushtetit vendor nuk i përdorin fare kasat fiskale, pavarësisht se atyre u është rimbursuar vlera e kasës fiskale.

U bë aq zhurmë kur u vendosën kasat fiskale, ku shteti ose u a rimbursoi ose u njohu si të paguar vlerën e taksës për 6 muaj-deri 1 vit. Por nuk u kujtua më kush për to.

Po a u rrit xhiroja e subjekteve për të kontribuar më raport me fitimin? Përgjigja është, JO, nuk është rritur xhiroja, por ajo ka mbetur në vend dhe çfarë rritje kërkohet kur kasat fiskale nuk përdoren?

Do thotë dikush që merr vesh sado pak nga këto punë, po shteti ka nxjerrë ligj dhe VKM për kasat fiskale. Po është e drejtë, ka nxjerrë ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011 dhe sipas nenin 122 shkronja "b" dhe "c" të pikës 1, të ndryshuar, përcaktohet se: ku tatimpaguesi sipas shkronjës b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo shërbimeve, për çdo rast konstatimi dënohet me gjobë (i diferencuar sipas numrit dhe herëve të konstatuara nga 100 000 - 500 000 ose mbylljen e veprimtarisë deri në 6 muaj).

Po a zbatohet ky ligj në praktikë? Përgjigja është jo. Edhe në ndonjë rast kur zbatohet është i diferencuar. Personat e ngarkuar me kontrollin e funksionimit të kasave fiskale, të Drejtorive Rajonale të Tatimeve, në disa raste veprojnë me dy standarde. Pasi në një rrugë, subjekti nuk është i pajisur me leje ushtrimi aktiviteti por nuk ndëshkohet, pasi mund të "Votojë CASH", ndërsa subjekti përbri që nuk përdor kasën fiskale gjobitet.

Subjektet e biznesit të vogël që ushtrojnë aktivitetin në pushtetin vendor për mos lëshimin e kuponit tatimor, nuk ka të drejtë ta ndëshkojë administrata e taksave të bashkisë apo komunës, por administrata e Drejtorive Rajonale të Tatimeve. Ose më shqip, nëse një subjekt i biznesit të vogël nuk përdor kasën fiskale dhe nuk lëshon faturën tatimore, në Bashkinë Bulqizë, duhet të vijë ta kontrollojë dhe vendosë gjobën inspektori i Drejtorisë Rajonale të Peshkopisë. Por a mundet që administrata rajonale e tatimeve të ushtrojë kontrole në një subjekt të biznesit të vogël, që nuk përdor kasën në Komunën më të thellë ?

Mos pagesa e taksave dhe rritja e debitorëve edhe pse u falën, pra u fshinë nga librat kontabël dhe shkuan në zero, ka ardhur edhe nga moszbatimi i instrumenteve ligjore “shtrënguese” që janë në fuqi.

Përveç kërkesave për marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës, KLSH për përmirësimin e metodës së punës ka **rekomanduar si më poshtë:**

a-Dërgimin Bankave të urdhrave të bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”.

b-Dërgimin në Drejtoritë Rajonale të Transportit, vendosja e bares siguruese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c- Aplikimin nga administrata tatimore e kamatë vonesave për mos pagesën në afat të taksave, në zbatim të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 04.12.2014, ku përcaktohet se në rastet e mos pagesave në afat ndaj subjekteve vendoset gjobë e barabartë me 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, për të cilën pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë kalendarike.

d- Të kërkohet kallëzim penal ndaj subjekteve të parregullta, veçanërisht atyre të cilat nuk kanë paguar me vite, në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i

ndryshuar, pikat 130-132 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 - **Mospagimi i taksave dhe tatimeve.**

Vlen për të theksuar se vetëm si rezultat i rekomandimeve të cituara më sipër, nga KLSH, gjatë vitit 2014 janë arkëtuar në buxhet nga 23 subjekte, në vlerën **85 826 mijë lekë**, respektivisht:

- **Bashkitë:** Vlorë 27 000 mijë lekë, Rrogozhinë 3 870 mijë lekë, Burrel 3 269 mijë lekë, Elbasan 1 684 mijë lekë, Ura Vajgurore 930 mijë lekë, etj.
- **Komunat:** Kashar 13 731 mijë lekë, Qendër Fier 2 480 mijë lekë, Qendër Librazhd 1 762 mijë lekë, Pezë 2 172 mijë lekë, Farkë 1 500 mijë lekë, Golem Kavajë 2 158 mijë lekë, etj.

Pavarësisht nga efektet që pretendohet të japë reforma e ndërmarrë nga Qeveria për kalimin e pagesës së tatimit të thjeshtuar nga ana e subjekteve në Drejtoritë Rajonale Tatimore, puna në teren le për të dëshiruar, pasi grumbullimi i këtij lloj tatimi ka ardhur duke u përkeqësuar dhe për pasojë bashkitë dhe Komunat nga mos xhirimi i këtij tatimi, nga Drejtoritë Rajonale të Tatimeve, nuk kanë kryer investimet e parashikuara dhe kanë krijuar problemin zinxhir të faturave të palikuiduara.

Meqenëse jemi në fillim të zbatimit të reformës territoriale, del detyrë e organeve dhe institucioneve të ngarkuara me zbatimin e kësaj reforme për nxjerrjen sa më shpejt të akteve nënligjore veçanërisht të udhëzimeve konkrete.

Do kërkonim që në vëmendje të jetë pasqyrimi i taksave në kontabilitet dhe madje me detyrim edhe në formë elektronike, pasi duke mos qenë të regjistruara në bilancet kontabile të bashkive apo komunave, me bashkimin apo suprimimin e tyre, ekziston mundësia e fshirjes së detyrimeve të papaguara nga evidencat që janë mbajtur.

Të gjithë TV komentojnë në çdo emision çfarë tha njëri apo tjetri politikan, analiza të kronikave të zeza, nuk lihet Vidio Klip pa prezantuar etj, etj dhe mirë bëjnë, por si nuk dëgjuam një emision dhe thirrje për pagesën e taksave, mbi të cilat funksionon shteti, veçanërisht Televizioni Shqiptar për të cilin qytetarët paguajnë edhe taksat.

Mendojmë se ekzistojnë kapacitetet njerëzore me specialistë të fushës tatimeve për organizimin e emisioneve sensibilizuese për pagesën e taksave vendore dhe ndërgjegjësimin e subjekteve për pagesën e tyre, dhe pse jo duke u njohur edhe me kamatë-vonesat dhe kuadrin ligjor në fuqi për mos-pagesën e taksave vendore.

Ne jemi edhe konsumatorë dhe shikojmë që nuk jepet kuponi tatimor. Herë pas herë bëhet sikur sensibilizohen qytetarët me fletë palosje. Nuk zgjidhet problemi me fletë palosje dhe lutje. Por duhet ndryshuar ligji, jo me gjoba, sikur është parashikuar, por nuk preve kuponin vendose gjobën, po nuk pagove taksën mbyll aktivitetin, lokalin, konfisko mallin. **Publikoi në mediat lokalet subjektet që nuk presin kuponë tatimorë apo nuk paguajnë taksat dhe efekti patjetër do të vijë.**

Ky absurditet duhet të marrë fund duke bërë ndryshime në ligj dhe VKM për vendosjen e kasave fiskale. Duke u dhënë kompetencë gjobe edhe administratës së taksave të bashkive apo komunave që do te dalin nga zgjedhjet e reja. Taksat nuk janë të papërballueshme në shumën 25 000 lekë/vit ose 70 lek/ditë, sa një kafe. Kur një nëpunës paguan më tepër. Atëherë pse nuk paguhen taksat?